



**Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë**  
**Prezenca e OSBE-së në Shqipëri**

**Konferencë për Shtyp**  
**Ambasadori Pavel Vacek, Kryetar i Prezencës**  
**5 nëntor 2004**

Mirëdita, zonja dhe zotërinj!

Do të doja t'ju uroja të gjithëve mirëseardhjen. Unë jam i gëzuar që po takohem me përfaqësues të medias shqiptare, që me sa kam mësuar është shumë dinamike dhe aktive. Unë duhet t'ju kisha dhënë këtë mundësi që më parë; por koha në të cilën organizojmë këtë konferencë për shtyp u përcaktua nga nevoja për të përfunduar një seri takimesh me përfaqësuesit kushtetues në vend. Muaji që ka kaluar që prej mbërritjes sime këtu më lejon që të kem një bashkëbisedim më të mirë me ju.

Gjithashtu, unë jam i gëzuar t'ju prezantoj me një anëtar të ri të nivelit të lartë të personelit të Prezencës, z. Wolfgang Sporrer nga Austria, Kryetar i Departamentit të Demokratizimit.

Së pari, unë jam shumë i lumtur që jam në Shqipëri si Kryetar i Prezencës së OSBE-së dhe shpresoj që të punoj dhe jetoj këtu për disa kohë. Po ashtu, më ka lënë shumë mbresa realiteti shqiptar – natyra e tij dinamike, si edhe kontrastet e tij. Unë e kuptoj që vendi ka përshkuar një rrugë të gjatë që nga kaosi i vitit 1997. Ndërtesat e reja, dyqanet dhe investimet e huja gjithmonë në rritje janë dëshmi rimëkëmbjeje dhe ripërtëritjeje. Rendi publik ka pësuar përmirësime. Ekziston një shkallë e lartë ndërgjegjësimit për objektivat strategjike të vendit. Aspiratat shqiptare për integrimin në BE dhe NATO njihen, vlerësohen dhe mbështeten nga të gjithë partnerët kryesorë ndërkombëtarë.

Megjithatë, disa nga arsyet për të cilat OSBE-ja erdhi në Shqipëri ekzistojnë ende. Në fund të vitit 2003, mandati i Prezencës së OSBE-së u ndryshua për të pasqyruar situatën e përmirësuar dhe për të përqendruar më mirë punën e saj. Qëllimi i OSBE-së në Shqipëri vazhdon të jetë nxitja e demokratizimit, shtetit të së drejtës dhe e të drejtave të njeriut, si dhe konsolidimi i institucioneve demokratike në përputhje me parimet, standardet dhe angazhimet e OSBE-së.

Një sërë fushash ku ne kemi një mandat për t'i siguruar asistencë dhe ekspertizë autoriteteve dhe shoqërisë civile rrjedhin nga qëllimi ynë kryesor: ne mbështesim reformat ligjvënëse, gjyqësore, të pronave, si dhe për ndarjen territoriale administrative; ne sigurojmë asistencë për reformën zgjedhore – një nga detyrat më të rëndësishme në kuadrin e zgjedhjeve të vitit 2005. Ne ndihmojmë në forcimin e kapaciteteve të Kuvendit. Ne po mbështesim përpjekjet shqiptare në fushën e anti- trafikimit dhe anti-korrupsionit, sigurojmë asistencë për policinë, në veçanti për policinë kufitare. Ne ndihmojmë për sigurimin e ligjeve dhe rregulloreve efikase për median. Prezenca ndihmon në nxitjen e mirë-administrimit dhe forcimin e shoqërisë

civile. Për të gjitha këto, bashkëpunojmë ngushtë me organizma të tjerë ndërkombëtarë.

Unë do të doja të theksoja se përmirësimi i legjislacionit zgjedhor dhe përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme parlamentare janë përparësi. Shqipëria duhet të lerë pas praktikat e kaluara të zgjedhjeve të kontestuara që nuk kanë mundur të arrijnë standardet ndërkombëtare. Rëndësia e zgjedhjeve të vitit të ardhshëm për vendin dhe ambiciet e tij është e paçmuar. OSBE-ja po bën më të mirën: ODIHR-i ka nxjerrë rekomandime për legjislacionin zgjedhor, Prezenca po e mbështet procesin në mënyrë aktive. Së bashku me BE-në, ne do të asistojmë në mënyrë masive në procesin e regjistrimit të zgjedhësve. Megjithatë, procesi drejt zgjedhjeve është shumë i ngadalshëm dhe jo rezultativ sa duhet. Kuvendit i mbetet ende të zgjidhë çështjet e rishikimit dhe ndryshimit të dispozitave për procedurat e votimit në ditën e zgjedhjeve, ato të zonave zgjedhore, shpërndarjes së mandateve proporcionale si dhe disa çështje të tjera. Ne shpresojmë se kalendari i përgatitjes së zgjedhjeve do të respektohet. Kjo varet nga vullneti politik i ligjvënësve dhe kapaciteti i administratës si në nivel qendror ashtu edhe vendor. Mosarritja e zgjedhjeve të lira e të ndershme në vitin 2005 do të ishte një hap serioz mbrapa jo vetëm për aspiratat për integrim të vendit, por edhe për vetë demokracinë shqiptare. Përgjegjësia për përgatitjen dhe zhvillimin e zgjedhjeve bie mbi përfaqësimin politik dhe administratën shqiptare, ndërsa rezultati i zgjedhjeve duhet të jetë në duart e zgjedhësve shqiptarë.

Gjithashtu, ne e konsiderojmë përparësi vazhdimin e asistencës për zbatimin e legjislacionit për kthimin dhe kompensimin e pronave. Shumë prej gjërave që ne bëjmë nuk janë të dukshme, por kjo nuk e zvogëlon rëndësinë e tyre. Ne ndihmojmë në lehtësimin dhe ndërtimin e konsensusit, ndihmojmë në hartimin e akteve ligjore e nënligjore dhe udhëzimeve, forcojmë kapacitetin e autoriteteve shtetërore përkatëse, dhe sigurojmë ekspertizë vendase dhe të huaj.

Prezenca do të vazhdojë t'i japë mbështetje policisë shqiptare si me trajnime ashtu edhe në bashkëpunimin ndërkufitar. Ne vazhdojmë të bëjmë një gjë të tillë në bashkëpunim me organizma të tjerë, kryesisht me PAMECA-n. Kur është e mundur, ne do të mobilizojmë burimet e kufizuara për të dhënë asistencë materiale. Dhurimi i sistemit të komunikimit me radio Policisë Shqiptare është një shembull konkret.

Në të ardhmen e afërt, nuk priten ndryshime dramatike në lidhje me atë që ne bëjmë. Ka një vazhdimësi të mandatit, të punës që duhet bërë dhe të njerëzve në Prezencë, si ekspertë ndërkombëtarë ashtu edhe vendas. Më ka lënë mbresa ekspertiza dhe vendosmëria e personelit tonë të Prezencës. Numri i personelit shqiptar po rritet ndërkohë që ai ndërkombëtar po zvogëlohet dhe kjo prirje do të vazhdojë. Ne do të duhet të vazhdojmë të operojmë në shkallë vendi, të paktën për sa u përket programeve të mëdha, të tilla si : mbështetja e reformës zgjedhore, shteti i së drejtës, ndihma për qeverisjen vendore dhe policinë, mbështetja për shoqërinë civile. Për këtë qëllim, roli i zyrave tona rajonale është thelbësor dhe do të vijojë të jetë i tillë edhe për ca kohë në të ardhmen.

Nga ana tjetër, ka vend për ndryshime përsa i përket mënyrës se si e kryejmë punën tonë. Këtu theksoj se jemi të vendosur të konsultohemi më nga afër me autoritetet shqiptare në të gjitha nivelet për përmbajtjen e punës sonë, konkretisht për programet dhe projektet. Unë kam ftuar disa prej tyre – ministrat, me të cilët lidhet puna jonë –

për të paraqitur lista me sugjerime konkrete për identifikimin e fushave ku është më e nevojshme mbështetja jonë. Jemi angazhuar për ndërmarrjen e një konsultimi me Qeverinë (MPJ-në) para mbylljes së këtij viti për të rregulluar sa më mirë veprimtaritë tona të planifikuara sipas kërkesave të vendit pritës. Kjo është në përputhje me synimin tim, si Kryetari i ri i Prezencës, për ta orientuar punën tonë më tepër drejt kërkesave. Në të njëjtën kohë, kemi besimin se ajo që kemi bërë deri tani është mbështetur në kërkesat e partnerëve shqiptarë, si të autoriteteve ashtu edhe të sferës jo-qeveritare.

Konsultimi ynë me vendin pritës është çelësi për suksesin tonë të përbashkët si përsa i përket kërkesës ashtu edhe mbështetjes së palës shqiptare për punën tonë. Megjithatë, në mënyrë më të përgjithshme, ne udhëhiqemi gjithashtu nga *acquis* i OSBE-së, mandati ynë dhe vullneti i përbashkët politik i 55 shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së. Këto do të përcaktojnë gjithashtu se për sa kohë do të vazhdojmë të punojmë në Shqipëri dhe me Shqipërinë. Theksoj se jemi këtu sepse të 55 shtetet pjesëmarrëse, përfshirë edhe Shqipërinë, kanë dashur që ne të jemi këtu dhe do të vazhdojmë të ndihmojmë për aq kohë sa paraqitet nevoja dhe dëshira. Ne do të vazhdojmë të veprojmë në këtë mënyrë në konsultim me partnerët tanë ndërkombëtarë, së pari me organizmat e tjerë ndërkombëtarë të pranishëm në Shqipëri.

Faleminderit!

#### **THE ASSOCIATED PRESS**

**Pyetje: Z. Ambasador, në mos gaboj, ju thatë që procesi i reformës elektorale është duke ecur ngadalë. Pas një muaj takimesh që keni pasur me forcat politike dhe autoritetet e tjera, cili është mendimi juaj, a do të arrijnë këto forca politike t'i plotësojnë në kohë ato rezultate që duhen në këtë reformë dhe çfarë keni komunikuar ju në këto kontakte që keni pasur?**

**Ambasadori Vacek:** “Unë e konsideroj një objektiv realist. Unë do të doja, gjithashtu, që të thosha se vullneti politik në fakt ekziston, gjithsesi ky proces duhet të përshpejtohet. Ne e kemi ofruar mbështetjen tonë për këtë proces nëpërmjet Grupit të Ekspertëve Teknikë dhe ky grup punon në bashkëpunim dhe në mbështetje të komisionit parlamentar. Baza për këtë mbështetje që Prezenca po i jep parlamentit janë rekomandimet e Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut. Pjesa tjetër i mbetet në dorë përfaqësimit politik të vendit”.

#### **GAZETA SHQIPTARE**

**Pyetje: Disa nga propozimet e Grupit të Ekspertëve nuk kanë sjellë reagime në komisionin parlamentar, por ai që ka sjellë një reagim të fuqishëm ka qenë propozimi i fundit për përbërjen e KZZ-ve, në të cilat përdoren dy kritere, rezultati i zgjedhjeve të 2001-shit dhe rezultati i zgjedhjeve të 2003-shit. Si mendoni, vendimi i marrë nga KQZ në 2001, që bën renditjen e partive të opozitës, nuk duhet marrë për bazë dhe pse një gjë e tillë?**

**Ambasadori Vacek:** “Kjo është, sigurisht, në dorë të organit përgjegjës, që është parlamenti dhe të aktorëve të përfshirë. OSBE-ja do të respektojë vendimin e tyre për aq kohë sa ky vendim do të jetë në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR-it”.

### **TELEVIZIONI KOHA**

**Pyetje: Z. Ambasador, siç thatë edhe ju, çështja e zonave elektorale mbetet ende e pazgjidhur, madje është kontestuar nga opozita. A do të ndërhyjë OSBE-ja për ta zgjidhur këtë çështje përpara se të kthehet në ligj dhe a do ta garantojë respektimin e rreptë të ligjit?**

**Ambasadori Vacek:** “Faleminderit për pyetjen. Grupi i Ekspertëve Teknikë ka kontribuar tashmë në komisionin e posaçëm parlamentar lidhur me zonat zgjedhore dhe, nëse s’gabohem, kjo është bërë në fillimet e vjeshtës së këtij viti. Dhe, përsëri, do të thosha që kjo mbetet në dorë të debatit politik dhe parlamentit. Ne padyshim presim dhe shpresojmë që rezultati do të jetë në përputhje me standardet dhe rekomandimet. Përsa i përket garatimit të çfarëdolloj rezultati që mund të dalë nga procesi zgjedhor, unë do të thosha që OSBE-ja, si organizatë, nuk është një garantuese e çfarëdolloj rezultati të proceseve në secilin nga 55 vendet anëtare të saj. Ne, sigurisht, asistojmë dhe monitorojmë procese të tilla, por garantët janë vetë institucionet kushtetuese shqiptare”.

### **AGJENCIA TELEGRAFIKE SHQIPTARE**

**Pyetje: Më lejoni t’i parashtroj pyetjes sime vlerësime për punën dhe objektivitetin e organizatës që ju kryesoni. Në fjalën tuaj, ju ritheksuat rëndësinë e organizimit të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme për proceset integruese të Shqipërisë në strukturat euro-atlantike. A mund të di opinionin tuaj paraprak në rast kontestimi të këtyre zgjedhjeve, duke marrë parasysh faktin që edhe demokracitë më të mira ose më të vjetra në botë kanë ndonjëherë probleme në proceset zgjedhore? Dhe më lejoni të bashkëngjis një pyetje të vogël: a keni gjetur një frymë bashkëpunimi të mirë me autoritetet shqiptare gjatë punës së deritanishme në Shqipëri?**

**Ambasadori Vacek:** “Ju faleminderit shumë, sidomos për vlerësimin që i bëtë punës sonë. Pikësepari, çdo gjë që ne kemi bërë dhe që synojmë të bëjmë ka për qëllim moskontestimin e zgjedhjeve. Sigurisht që ka dispozita që parashikojnë se ç’bëhet në rast kur zgjedhjet kontestohen, pra ka mundësi për kontestim të ligjshëm të zgjedhjeve, por qëllimi ynë i përgjithshëm është shmangia e kontestimeve. Mbetet në duart e aktorëve politikë shqiptarë nëse kjo do të arrihet apo jo. Dhe, nëse do të bëja një apel këtu, ai do të ishte një apel për përgjegjshmëri. Përsa i përket pyetjes së dytë, mund t’ju konfirmoj se deritani kam hasur një sjellje pozitive nga autoritetet, sidomos nga zyrtarët kushtetues dhe përfaqësuesit që kam takuar deri në tash. Unë mund të flas, në fakt, për një frymë bashkëpunimi që kam konstatuar në të gjitha kontaktet që kam pasur deri tani. Shpresoj shumë që të vazhdojë kështu”.

### **RADIOTELEVIZIONI ALSAT**

**Pyetje: Si e shikoni korrupsionin në administratën shqiptare, duke pasur parasysh edhe një raport të Transparency International, që e rendit Shqipërinë pas Ugandës? Mund të bëni një koment për votimin që do të bëhet për heqjen e mandatit të një deputeti botues pas pak ditësh në parlament?**

**Ambasadori Vacek:** “Lidhur me pyetjen e parë, sinjerisht unë nuk do të komentoj studimin e tyre, i cili është gjerësisht i njohur dhe i komentuar këtu. Ai raport është ndoshta, në një farë shkalle, tregues i simptomave të gjendjes së përgjithshme, të paktën deri në atë shkallë që ne i konsiderojmë të rëndësishme raportet e Transparency International. Por ndoshta kjo është e gjitha që mund të them lidhur me këtë.

Në lidhje me heqjen e imunitetit të deputetit Lesi, unë do të thoja, në fakt, që nuk jam shumë në dijeni të këtij rasti. Kam dëgjuar për të më tepër nga media, prandaj nuk mund të bëj ndonjë koment. Gjithsesi, shpresoj që ky rast të trajtohet duke respektuar plotësisht legjislacionin shqiptar”.

### **VIZION PLUS**

**Pyetje:** Ish-ambasadori i OSBE-së, Lipponen, është kundërshtuar shumë në punën e tij, kryesisht nga partitë e majta, që kanë kërkuar edhe largimin e tij dhe të Prezencës së OSBE-së. Madje edhe vetë Partia Socialiste e ka quajtur të pamjaftueshme punën e ekspertëve të OSBE-së dhe ka kërkuar ekspertë të ODIHR-it. Madje z. Lipponen është akuzuar edhe si favorizues i opozitës. Ju personalisht a do të përpiqeni për të vendosur një ekuilibër lidhur me maxhorancën dhe partitë e majta për të vendosur rolin e OSBE-së aty ku duhet?

**Ambasadori Vacek:** “Kjo përfshin disa pyetje në vetvete, por më lejoni që t’i marr një nga një elementet. Së pari, politika ime është që të mos bëj komente për paraardhësit e mi, megjithatë në nivel personal, mund t’ju them se unë e kam njohur si një njeri shumë të pjekur, me përvojë dhe të këndshëm. Përsa i përket asaj që unë do të bëj, do të thoja që ajo do të bazohet në vazhdimësinë e punës që ka bërë ai. Nuk i di me hollësi akuzat ose rekomandimet që i janë bërë paraardhësit tim. Unë, sigurisht, jam i vendosur të punoj në mënyrë të pavarur me të gjithë partnerët politikë të gatshëm lidhur me reformën zgjedhore, sepse, kjo është besoj çështja për të cilën po flasim. Unë besoj se kjo është dëshmuar nga disa gjëra konkrete që kemi bërë në këtë aspekt. E kemi treguar, gjithashtu, se në punën për reformën zgjedhore ne punojmë bashkërisht me ODIHR-in, dhe një dëshmi konkrete është zhblllokimi i çështjes së ristrukturimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Dua të them edhe diçka tjetër: ndërsa punojmë me të gjithë partnerët e gatshëm, ne, njëkohësisht duhet të respektojmë raportin e forcave në parlament, dhe është ky raport që përcakton, në shumicën e rasteve, rezultatin e diskutimeve në parlament. Në një farë mënyrë, kështu ndodh në çdo demokraci”.

“Ishte kënaqësia ime dhe do të vazhdojë të jetë kënaqësia ime t’ju takoj më shpesh dhe më rregullisht, qoftë së bashkur, ose individualisht. Faleminderit që gjetët kohën dhe e ndatë atë me mua. Faleminderit shumë”.